

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

VARIANTI A

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

**Shkollat e mesme teknike profesionale
(kurrikula e vjetër)**

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	9	10
Pikët											
Kërkesa	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21a
Pikët											
Kërkesa	21b	22a	22b	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Mjeda***Andrra e jetës**Lokja*

U shty vjeshta e krisantemi
 Vetun vorreve lulzon;
 Landët e pyje, gjith ku kemi,
 Tuj fry veri po i cungon.

Ndrroon prej dimnit landa veshen,
 E lëshon gjetht që para pat;
 E, për mëshirë, duhitë që ndeshen,
 Ia çojnë t'vorfnit me i ba shtrat.

Bite borë e fryte veri
 Tuj çue akull për gjithë vis;
 Nalt orteku ushton për mneri
 Tuj fundue çetinë e lis.

Me dy cokla n'votër plaka
 Rri gjithë natën e vajton;
 Rri me duer kah ndezet flaka
 porsi nieri kur uron.

E shikjon një dritë t'venitun;
 Vron pasqyrën e jetës s'vet:
 E larg Morden tuj kositun
 E kujton e pran' e thrrret.

U ndie'j frymë përbrenda shpijet
 Porsi erë që vjen pa shkas;
 E n'at muzg, një vegim hijet
 Lokes n'votër let' iu qas:

Përmbi plakën krahët i uli
 E n'gryk t'shuemen e shtrëngoi;
 Buzët t'shpulpueme n'ball ia nguli;
 U ndal drita e ajo mbaroi.

Fjalor:

Landët e pyje- lëndët e pyjeve
Duhi – erë e fortë
Mner – tmerr
Tuj fundue – duke fundosur
Uron – lutet

frymë – përfytyrimi i vdekjes si një frymë
pa shkas – pa shkak
vegim hijet - mortja
buzët e t'shpulpueme- buzët që s'kanë mish

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.

1. Detaji i *krisantemës* në strofën e parë nënkupton: **1 pikë**
 - A) ardhjen e stinës së vjeshtës.
 - B) peizazhin e zyrtë të stinës së dimrit.
 - C) paralajmërimin për afrimin e vdekjes.
 - D) rigjallërimin e natyrës edhe në dimër.

2. Vargjet e këtij fragmenti janë shkruar me varg: **1 pikë**
 - A) 8-rrokësh;
 - B) 9- rrokësh;
 - C) 10- rrokësh;
 - D) 11- rrokësh.

3. Cila është figura mbi të cilën ngrihet gjendja psikologjike dhe fizike e Lokes? **1 pikë**
 - A) Alegoria;
 - B) Simboli;
 - C) Krahasimi;
 - D) Paralelizmi figurativ.

4. Lokja ndihet e brengosur sepse: **1 pikë**
 - A) vdekja po i afrohet shumë shpejt.
 - B) sapo ka humbur njëri nga vajzat.
 - C) ka mbetur vetëm pa askënd pranë.
 - D) nuk mund të ngrohet në atë dimër të ashpër.

5. Në cilën prej vargjeve të mëposhtme shfaqet varfëria e skajshme e Lokes? **1 pikë**
 - A) Rri me duer kah ndezet flaka
 - B) Me dy cokla n'votër plaka
 - C) Vron pasqyrën e jetës s'vet
 - D) U ndie'j frymë përbrenda shpijet

6. Ndikimi i Mjedës nga folklori duket në: **1 pikë**
 - A) përfytyrimin e vdekjes me kosë në dorë.
 - B) përshkrimin e natyrës.
 - C) përshkrimin e jetës në malësi.
 - D) motivin e kohës që ikën.

7. Përshkruani me pak fjalë atmosferën që mbizotëron në këtë fragment. Cili është funksioni artistik i një zgjedhjeje të tillë nga ana e autorit? **2 pikë**

8. Në ç' moment të jetës ndodhet Lokja? Cilat janë ndjesitë që ajo po përjeton? Shpjegoni pse. **3 pikë**

9. Cili është ritmi i këtij fragmenti? Shpjegoni arsyen e kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit. **2 pikë**

ritmi: _____

shpjegimi: _____

10. Zbërtheni nëntekstin në vargun e mëposhtëm: **2 pikë**

E shikon një dritë t'venitun

11. Gjeni sinonimin e fjalës *t' shuemen*. Cili është funksioni artistik i këtij përdorimi? Kthejeni këtë fjalë në shqipen standarde. **3 pikë**

E n'gryk t'shuemen e shtrëngoi;

sinonimi: _____

funksioni: _____

shqipja standarde: _____

12. Imazhi më i fuqishëm në dy vargjet e fundit është ai i vdekjes. Mbi cilën figurë të stilistikës është ngritur ai? Komentojeni atë, duke u mbështetur në fjalët kyç që krijojnë këtë imazh. **3 pikë**

PJESA II

Flobër

Zonja Bovari (fragment)

Ajo do të kishte dashur që emri Bovari, që ishte edhe i saji, të bëhej i famshëm, të gjendej kudo nëpër librari, të përmendej vazhdimisht nëpër gazeta, ta njihje e tërë Franca. Mirëpo Sharli ishte njeri pa pikë pikësnyimi në jetë! Një herë një mjek nga Ivtotoja, me të cilin para pak kohësh po bënte konsultë, e kishte poshtëruar disi mu përpara shtratit të të sëmurit, në prani të të afërmeve që ishin mbledhur aty. Kur ia tregoi Sharli këtë ndodhi në darkë, Ema u nxeh shumë me kolegun e tij. Sharli u prek nga reagimi i së shoqes. E puthi në ballë me lot ndër sy. Mirëpo ajo ishte e pezmatuar nga turpi, i vinte ta rrihte, doli në korridor të hapte dritaren dhe thithi ajrin e freskët për t'u qetësuar.

- Sa i humbur që është! Sa i humbur që është! – thoshte ajo me zë të ulët, duke kafshuar buzët.

Dhe sa vinte dhe më tepër e merrte inat. Me kalimin e moshës, ai fitonte gjithmonë e më shumë shprehje prej të pagdhenduri; mbas darke priste me thikë tapat e shisheve bosh; pasi hante, lëpinte dhëmbët me gjuhë; kur rrufiste supën, kuaçiste si kllaçkë në çdo gllënjë, dhe, ngaqë dhjamosja po e zaptonte gjithandej, sytë, tashmë të vecërr, dukeshin sikur po i ngjiteshin drejt tëmthave prej mbufatjes së mollëzave.

Ema, nganjëherë ia fuste nën jelek fundin e kuq të trikos, i drejtonte kravatën, ose ia hidhte tej dorashkat bojëdala që ai ishte gati t'i vishte; dhe këtë ajo nuk e bënte, siç kujtonte ai, për të; e bënte për veten e saj, si shprehje egoizmi të shfrenuar, acarimi nervor. Bile ndonjëherë i tregonte gjëra nga ato që kishte lexuar, si për shembull, ndonjë pjesë romani, ndonjë dramë, ose ngjarjen e fundit të *shoqërisë së lartë*, që përshkruhej në fejttonin e gazetës; sepse, në fund të fundit, dhe Sharli njeri i gjallë ishte, gjithmonë e dëgjonte me vëmendje, gjithmonë ia miratonte ato që i thoshte. Shpesh herë ajo ia hapte zemrën zagarit të saj të vogël! Po kështu do të kishte bërë edhe me kërcunjtë e oxhakut dhe me lavjerrësin e sahatit.

Ndërkaq, thellë në shpirt, ajo priste të ndodhte diçka. Ashtu si detarët në rrezik për t'u mbytur, ajo shikonte vetminë e jetës së vet me sy të dëshpëruar, duke kërkuar diku larg ndonjë velë të bardhë në mjegullnajën e horizontit. Nuk e dinte cili do të ishte ai rast, as se në ç'breg do ta nxirrte, i shtyrë nga era deri tek ajo, as në do të ishte barkë a anije me tri kuverta, ngarkuar me vuajtje apo mbushur deng me lumturi. Mirëpo çdo mëngjes, sa zgjohej, ajo shpresonte se do t'i vinte gjatë ditës, dhe dëgjonte të gjitha zhurmat, brofte befash, çuditej që nuk vinte, pastaj, si perëndonte dielli, më e trishtuar se kurrë, dëshironte që të gdhijej në çast e nesërmja.

.....
zemra e saj mbeti e zbrazët përsëri dhe atëherë filloi sërish vargu i ditëve të njëllojta.

Ato do të pasonin pra kështu njëra-tjetrën, gjithmonë të njëjta, të panumërta dhe pa sjellë asgjë! Të tjerët, sado të rëndomtë ta kishin jetën, prapëseprapë shpresonin të paktën se do t'u ndodhte diçka. Nganjëherë një aventurë mund të sjellë të papritura pambarim, bile edhe mjedisi sikur ndërrohet. Mirëpo për të nuk ndodhte asgjë; kështu e kishte thënë zoti! E ardhmja e saj ishte si një korridor krejtësisht i errët dhe që përfundonte me një derë të pakapshme.

Ajo e braktisi muzikën. Përse të merrej me të? Kush do ta dëgjonte? Përderisa s'kishte për të ndodhur kurrë që, veshur me fustan të kadifenjtë me mëngë të shkurtra, ulur para ndonjë pianoje "Erard", për të dhënë koncert, duke i rënë me gishtërinjtë e saj të lehtë, tastierës së fildishtë, të ndiente t'i frynte si ndonjë fllad rreth vetes gumëzhitja e të mahniturve, ishte e kotë të lodhej duke studiuar. I plasi në dollap edhe kartonët e vizatimit edhe qëndisimat. Ç'i duheshin? Ç'i hynin në punë? Qëndisja i ngrinte nervat përperjetë.

- S'kam ç'të lexoj më, - thoshte ajo me vete.

Dhe kohën e kalonte duke skuqur mashën në zjarr ose duke parë shiun që binte.

Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.

- 13.** “Zonja Bovari” është njohur si një roman: **1 pikë**
- A) romantik;
B) filozofik;
C) psikologjik;
D) simbolist.
- 14.** Cila nga alternativat e mëposhtme jep më mirë thelbin e figurës së Sharlit? **1 pikë**
- A) Dhjamosja po e zaptonte gjithandej.
B) Sharli u prek nga reagimi i së shoqes.
C) Sharli ishte njeri pa pikë pikësnyimi në jetë.
D) Sharli njeri i gjallë ishte, gjithmonë e dëgjonte me vëmendje.
- 15.** Në fragmentin e dhënë më sipër shikojmë se ndjesia që Ema provon ndaj Sharlit është: **1 pikë**
- A) ftohtësi;
B) pëlqim;
C) keqardhje;
D) zhgënjim.
- 16.** Komentet e autorit, në lidhje me ëndërrimin e Emës për të ndodhur diçka, ilustron se ajo: **1 pikë**
- A) ndihet nën presion.
B) kërkon vëmendjen e të shoqit.
C) është e pushtuar nga mërzia.
D) dëshiron të përmirësojë martesën e saj.
- 17.** Në cilën prej alternativave të mëposhtme gjuha e përdorur nga autori bëhet veçanërisht figurative? **1 pikë**
- A) Po kështu do të kishte bërë edhe me kërcunjtë e oxhakut dhe me lavjerrësin e sahatit.
B) Me kalimin e moshës, ai fitonte gjithmonë e më shumë shprehje prej të pagdhenduri.
C) Të tjerët, sado të rëndomtë ta kishin jetën, prapëseprapë shpresonin të paktën se do t’u ndodhte diçka.
D) Ashtu si detarët në rrezik për t’u mbytur, ajo shikonte vetminë e jetës së vet me sy të dëshpëruar, duke kërkuar diku larg ndonjë velë të bardhë në mjegullnajën e horizontit.
- 18.** Me kalimin e viteve Sharli bëhet më: **1 pikë**
- A) kompetent në punën e tij.
B) monoton dhe i paedukuar në sjelljet e tij.
C) i kujdesshëm ndaj dëshirave të gruas.
D) i sigurt dhe nervoz ndaj të tjerëve.
- 19.** Në fjalinë që përmyll këtë fragment Ema shfaqet si një grua: **1 pikë**
- A) e interesuar pas motit.
B) e tërhequr nga pamjet e natyrës.
C) e përkushtuar ndaj vatrës familjare.
D) që e jeton jetën e saj thjesht si spektatore.

20. Zbuloni konfliktin themelor që shfaqet në këtë fragment. Zbërtheni thelbin e tij.

2 pikë

21.

a) Si e trajton Ema Sharlin? Shpjegoni arsyen e kësaj sjelljeje kundrejt tij.

2 pikë

b) Cili është koncepti që Ema ka për lumturinë? Pse ky koncept është jo realist?

2 pikë

22.

a) Çfarë pret Ema vazhdimisht? Komentoni se si jepet në mënyrë figurative kjo pritje.

3 pikë

b) Si ndihet Ema në lidhje me situatën në të cilën ajo ndodhet dhe cilat janë pasojat e këtij përjetimi që ajo po kalon?

2 pikë

23. Cila është arsyeja që Floberi përqendrohet kaq shumë në mërzitjen dhe kotësinë e jetës së Emës?

1 pikë

24. Identifikoni në fragment një rast ku gjuha e Floberit merr një ngarkesë ironie dhe shpjegoni se ku qëndron kjo ironi.

2 pikë
